



Datë: 09.06.2025
Numër Protokolli: 3941/2025

A.nr.772/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.772/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesi Z.B., kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 09.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.772/2025, e datës 30.04.2025, e parashtruar nga ankuesi Z.B.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Z.B., (*tutje referuar vetëm ankuesi*) më datë 30.04.2025, fizikisht, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar në Këshill më datë 30.04.2025, kundër Njoftimit të datës 27.03.2025, të Menaxherit të Personelit, të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës (tutje SHKK), ndërsa, kjo e fundit, më datë 21.05.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2862/2025 të datës 30.04.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e Kontratës së Punës për kohë të pa caktuar e datës 30.06.2018; Kopjen e rekomandimit për Përritje të Kontratës së Punës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kopjen e Extraktit të Lindjes Nr. E 00802807; Certifikatën e Vdekjes së I.B. Nr. V10765197 të datës 23.04.2025; Certifikatën e Vdekjes së M.B. Nr. V 10765198 të datës 23.04.2025; Certifikatën e lindjes Nr. L 02670386 të datës 20.09.2025; Kërkesën e datës 24.03.2025 të ankuesit për Burimet Njerëzore të SHKK-së dhe e-mailin e datës 24.03.2025 lidhur me parashtrimin e kësaj kërkesë për pagesat e një page shtesë me rastin e vdekjes së dy anëtarëve të ngushtë të familjes; Përgjigjen ndaj kërkesës e datës 27 mars 2025; Kopjen e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës; Kërkesën për

përgjigje në ankesë e datës 14.05.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 21.05.2025; Kopjen e përshkrimit të detyrave të punës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa është e pabazuar, **sepse**:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë në kuadër të SHKK-së, dhe së i njëjti ushtron pozitën “Zyrtare Korrektuese”.

Tutje, sipas provave materiale të çështjes del së ankuesi më datë 24.03.2025, ka parashtruar kërkesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore e organit të punësimit që duke u bazuar në nenin 29 pika 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ti bëjë kompensimin e një page bazë për rastin e vdekjes së dy anëtarëve të ngushtë të familjes (Vëllezërve) . Kurse, në përgjigje të kërkesës së ankuesit, Menaxheri i Personelit i SHKK-së, përmes njoftimit të datës 27.03.2025, ka njoftuar të njëjtin se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, konkretisht me nenin 45 janë shfuqizuar disa dispozita konkretit neni 29 i Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe rastet e ngjashme nuk janë ekzekutuar nga Thesari me arsyetimin se kompensimet me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes nuk janë paraparë me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, duke e udhëzuar palën ankuese që mund të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Ligji Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës parasheh kompensimin me rastin e vdekjes së anëtarëve të familjes dhe së i njëjti nuk është shfuqizuar nga Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, kështu që, kërkon që të anulohet njoftimi i kundërshtuar me ankesë, dhe të detyrohet Menaxheri i Burimeve Njerëzore i SHKK-së që ankuesit ti bëjë kompensimin e shumës së një page prej 1182.50 Euro, siç parashihet me paragrafin 1.3 të nenit 29 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Në kuptim të statusit ligjor të të punësuarve në Shërbimin Korrektues, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët ku përcaktohet: “1. *Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues....* 2. *Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkëljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. ..*” dhe si pasojë e këtij përcaktimi ligjor rrjedhë së të punësuarit në SHKK kanë statusin e nëpunësit civil me status të veçantë dhe së Këshilli ka kompetencë lëndore për trajtimin e kësaj çështje juridike-administrative.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit në kuptim të bazushmerisë së pretendimeve ankimore, fillimisht ju referuar Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, gjegjësisht nenit 29, paragrafi 1 dhe paragrafëve nga 1.1 deri në 1.3, ku përcaktohet: “1. *Përveç të Drejtave që janë të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit të Punës, personeli i SHKK-së ka edhe këto të drejta dhe detyrime specifike: 1.3. e drejta në shtesë të një page bazë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes...*”.

Duke marr parasysh që pagat, shtesat dhe kompensimin në sektorin publikë janë përcaktuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, (në fuqi nga data 05.02.2023), Kolegji i Këshillit, mori parasysh dispozitat e :

-Nenit 1, ku përcaktohet:1. *Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.*

-Nenit 2 paragrafi 1 dhe 3, ku përcaktohet: *1.Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.*

-Nenit 22 paragrafi 1, ku përcaktohet: *1. Shtesat që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale.*

- Nenit 35 paragrafi 1, ku përcaktohet: *1. Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit.*

-Nenit 45 paragrafi 1, nën paragrafi 1.15, dhe paragrafi 2, ku përcaktohet: *1.15. Neni 29, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1., 1.2., dhe paragrafi 4 i Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës. 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.*

Kolegji i Këshillit thekson faktin tani më të pakontestueshëm se Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i është nënshtuar vlerësimit të kushtetutshmërisë përmes Aktgjykimit për rastin nr. KO79/23, (në fuqi nga data 01.02.2024), e më të cilin aktgjykim është shpall i pavlefshëm paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë. Rrjedhimisht, lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të paragrafi 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, si dhe çështjen e efekteve juridike të këtij aktgjykimi në raport me ligjin e kontestuar, Gjykata Kushtetuese më aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, më konkret në pikën 377 ka specifikuar se : *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi), në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 5 i nenit 25 (Shtesa e performancës) dhe paragrafi 4 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën për sa i përket pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese, me theks në institucionet e përcaktuara përmes Kapitullit VII [Sistemi i Drejtësisë], Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura]. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, (i) paragrafi 2 i nenit 2 të Ligjit të kontestuar ua pamundëson institucioneve të pavarura kushtetuese që në përmbushje të pavarësisë së tyre kushtetuese të funksionojnë edhe me ligje të veçanta dhe e kufizon pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore vetëm në nxjerrjen e akteve nënligjore në rrethanat e përcaktuara*

specifikisht sipas Ligjit të kontestuar; (ii) paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të kontestuar shfuqizon çdo dispozitë të ligjit dhe akt nënligjor që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorive tjera në fushën e pagave, përfshirë të gjitha dispozitat e ligjeve të veçanta që ndërlidhen me institucionet e pavarura kushtetuese dhe aktet e tyre nënligjore...

Në fakt, Gjykata Kushtetuese përmes konstatimeve të dhëna në pjesën **IV. Efektet e Aktgjykimit**, ka sqaruar me pikën 376. *Konstatimet e Gjykatës sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, ndikojnë në efektet e këtij Ligji në dy mënyra. E para ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me sistemin e pagave dhe shpërblimeve dhe procedurave përkatëse për atë që afektojnë pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese.*

Në kontekst të analizimit të bazës kushtetuese si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin se me Aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, Gjykata Kushtetuese ka shpallur të pavlefshëm paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, vetëm në raport me institucionet e pavarura kushtetuese, e në këtë kontekst në vlerësimin e Kolegjit, rrjedhë së paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik është i zbatueshëm për institucionet tjera, dhe si pasojë çështja e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorive tjetër në fushën e pagave rregullohet vetëm sipas Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, akt ky ligjor që nuk ka përcaktuar të drejtën e zyrtarit publik për kompensim në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, andaj, mbi këtë gjendje faktike dhe juridike, pretendimet ankimore të ankuesit për kompensim të një page bazë për rastin e vdekjes së anëtarëve të familjes dy (vëllezërve) sipas nenit 29 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, janë të pabazuara ligjërisht.

Përmbledhur si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 53, paragrafi 1 dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda numër A.nr.772/2025

Avdyl BEKTESHI

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Procesmbajtëse

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Z.B.;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, në SHKK;
- Arkivit të KPMSHCK-së.